



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:040733
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05744375

Ac.nr.8676/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Halide Reka-anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Rr..... K..... nga fshati Slivovë, Komuna e Ferizajit dhe A.. R..... nga Komuna e Ferizajit, të përfaqësuar nga përfaqësuesja zëvendësuese D..... Xh..... avokat Ferizaj, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit material, vlera e pa përcaktuar, duke vendosur sipas ankesës së paditësve, kundër Akgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm numër 2021:040734 të datës 22.09.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e paditësve Rr..... K..... nga fshati Slivovë, Komuna e Ferizajit dhe A..... R..... nga Komuna e Ferizajit, **PRISHET** Akgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm numër 2021:040734 të datës 22.09.2022 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin, numër 2021:040734 të datës 22.09.2022, në pikën e parë të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar kërkespadinë e paditesve Rr..... K..... dhe A... R....., të dytë nga Komuna e Ferizajit. Në pikën e dytë të dispozitivit ka detyruar secilën palë që ti bart shpenzimet e veta të procedurës

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjore, ankesë kanë paraqitur paditësit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zabtimit të gabaur të së drejtës materiale, me propozimin që

Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndyshojë Aktgjykimin e atakuar duke e aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëve.

E paditura nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195, pika (c), të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre me datë 03.03.2021, kanë paraushtruar padi kundër të paditurës duke kërkuar që të kompnesohen për dëm material, ndërsa pas precizimit të kërkesëpadisë, paditësi R..... K..... ka kërkuar që e paditura ta kompnesojë për dëm material që iu është shkaktuar si pasojë e shiut dhe breshërit në grurë dhe mjedra në shumën prej 6.144.00 euro, ndërsa paditësi A..... R..... të kompnesohet për dëm material që iu është shkaktuar si pasojë e shiut dhe breshërit në grurë dhe mjedra në shumën prej 4.555,00 euro. Paditësit, kërkesëpadinë e mbështesin në vendimin nr. 01/58 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 24.07 2018 për krijimin e fondit për kompensimin e dëmeve të mundshme që mund t'i shkaktohen fermerëve.

E paditura, është përgjigjur përmes postës elektronike- email, ku ka njoftuar gjykatën se nuk do të jetë e pranishme në senacë për shkak të një senace tjetër në Vushtrri, andaj, gjykata ka vazhduar procedurën në mungesë të të paditurit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2021:040734 të datës 22.09.2022 me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të Aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se kërkesëpadija e paditësve është e pa bazuar për faktin se raporti i vlerësimit i Komunës së Ferizajit është në kundërshtim me vendimin e Qeverisë nr 01/58 të datës 24.07.2018, sepse sipas vendimit të Qeverisë, për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri në Komunitat e Kosovës, autorizohet Ministri i Financave për krijimin e një fondi të posaçëm për vitin 2019. Sipas të njëjtit vendim për kompensimin e dëmeve në sektorin e bujqësisë, formohet një komision i vecantë i kryesuar nga Ministria e Financave me përfaqësues nga Minsitria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Zyra e Kryeministrit. Raporti i lëshuar nga Komuna e Ferizji është në kundërshtim me vendimin e Qeverisë, konkretisht pikën tre (3) të vendimit sepse raporti është lëshuar nga organi jo kompetent dhe si i tillë nuk prodhon efekt juridik. Qeveria me asnjë akt nuk e autorizoi komunën që të formojë një komision në nivel komunal. Andaj, për shkak të mungesës së provave të tjera që do të vërtetonin bazën e kërkesëpadisë, gjykata e refuzon kërkesëpadinë e paditëve si të pa bazuar.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore nga 182 paragrafi 2 pika n), të LPK-së, meqë ka të meta që nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjyqimit nuk janë në harmoninë e duhur logjike dhe juridike, ndërsa faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar si duhet, për çka edhe nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si rezultat i së cilës nuk është bërë zbatimi i duhur i të drejtës materiale.

Në lidhje me këtë, Gjykata e Apelit vlerëson se duke i pasur për bazë pretendimet ankimore të paditësve, gjykatës së shkallës së dytë i ka rezultuar se, me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjyqimit nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me të gjitha pretendimet e ngritura nga palët paditëse gjatë zhvillimit të procedurës, të cilat janë ripërsëritur edhe në ankesën e parashtruar. Në këtë drejtim, bazuar në nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së, gjykata e shkallës së parë ka pasur për obligim që në arsyetim të aktgjyqimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato. Si rrjedhojë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjyqimit të atakuar nuk i ka trajtuar fare, përkatësisht nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm rreth pretendimeve të palëve paditëse, gjë e cila nuk është bazë e mjaftueshme për arsyetim, sepse si e tillë nuk mund të konsiderohet arsyetim në përputhje me atë që kërkohet dhe është e përcaktuar me dispozita ligjore.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, kishin ushtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, me kërkesë që të detyrohet e paditura që në emër të dëmit material të shkaktuar si pasojë e breshëritë t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 6.144,00 euro paditësit Rrahim Kadriu, ndërsa paditësit A..... R..... shumën e përgjithshme prej 4.939,00 si dhe shpenzimet e procedurës duke e mbështetur kërkespadinë e tyre në vendimin nr. 01/58 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 24.07. 2018 për krijimin e fondit për kompensimin e dëmeve të mundshme që mund t'i shkaktohen fermerëve dhe Raportin e Vlerësimit të Komunës së Ferizajit, Nr. 11 të datës 07.08.2018 dhe Raportin e Vlerësimit të Komunës së Ferizajit, Nr. 11 të datës 09.05.2018. Gjykata e shkallës së parë e kishte refuzuar kërkespadinë e paditësve me arsyetimin se Raporti i vlerësimit i datës 07.08.2018 dhe ai i datës 09.05.2018 janë lëshuar nga organi jo kompetent dhe si i tillë nuk prodhon efekt juridik, ngase, Qeveria me asnjë akt nuk e autorizoi komunën që të formojë një komision në nivel komunal. Sipas raporteve të vlerësimit nr.11 datë 07.08.2018 të datës 09.05.2018 ishte formuar komisioni nga Komuna Ferizaj prej tre anëtarëve të cilën kanë dalur në terren dhe kanë konstatuar se nga reshjet e shkaktuara nga shiu dhe breshëri paditësit R..... K..... iu është shkaktuar dëm në shumë prej 6.144,00 euro, ndërsa paditësit A.....R..... iu ishte shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 4.939,00 euro. Me vendimin me nr.01/58 të datës 24.07.2018 Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr vendim ku në pikën e 1 të këtij vendimi përcakton se *“për kompensimi ne menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri në Komunitat e Kosovës”*, në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet *“formohet komisioni i veçanti, i kryesuar nga Minsitria e Finacave, me përfaqësues nga Minsirtia e*

Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Zyra e Kryeminsitrit, për fillimin e punës për krijimin e sistemit të sigurimeve të prodhimtarisë bujqësore në Kosovë”, ndërsa në pikën 6 të këtij vendimi përcaktohet se “Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit”, pra ky vendim ka qenë në fuqi në kohën kur ka pas reshje dhe breshër, andaj edhe është krijuar baza për kompensimin e dëmit.

Për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që i njëjti të priset dhe lënda të rikthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Ashtu siç është formuluar dispozitivi I i aktgjykimit të atakuar, nëse në të ardhmen ishte me marrë formë të prerë, nuk mund të konstatohet se për cilën kërkesë gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë meritore, përkatësisht nuk do të mund të identifiohet çështja e gjykuar ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, në atë mënyrë që ta vlerësoj nëse e paditura e ka formuar komisionin e vecantë për krijimin e sistemit të sigurimeve të prodhimtarisë bujqësore në Kosovë sic parashihet në nenin 3 të Vendimit nr. 01/58 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 24.07.2018 për krijimin e fondit për kompensimin e dëmeve të mundshme që mund t'i shkaktohen fermerëve dhe mvarësisht fakti nëse neni 3 i Vendimit nr. 01/58 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 24.07.2018 është përmbushur dhe eventualisht nëse e paditura ka vërejtje lidhur me Raportet e Vlerësimit të Komunës së Ferizajit, ndërsa nëse e paditura nuk e ka formuar një komision të tillë, të konsiderohet nxjerrja e provës me ekspert të licencuar nga lëmija e bujqësisë, ku do të vlerësohet saktë dëmi i shkaktuar nga breshëri (lartësia e kërkesëpadisë së paditësve), në atë mënyrë që në bazë të ekspertizës të vërtetohet vlera monetare e dëmit të shkaktuar.

Ndërsa varësisht nga administrimi edhe i provave tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe vlerësimi i tyre të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës. Pas përfundimit të shqyrtimit gjykata duhet të ketë kujdes që vendimi në strukturë dhe përmbajtje të jetë në pajtim me dispozitën e nenit 160, lidhur me nenin 175 LPK-së, duke hartuar një dispozitiv të qartë dhe të përmbarueshëm në hamroni me kërkesat e palëve, si dhe arsyetim të mjaftueshëm, në të cilin të përfshihen provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është prishur në pjesën e parë, atëherë domosdoshmërisht është dashur të priset edhe pjesa e dytë e dispozitivit të tij, që ka të bëjë me shpenzimet procedurale, për të cilat, gjykata e shkallës së parë duhet të vendosë sërish në procedurën e rigjykimit.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika (c), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8676/22, me datën 23.05.2024

Kryetari i kolegjit
Ardian Ajvazi